



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
25.09.2025**

Me datë 25.09.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, , Irma Kopliku, Elis Doçi, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Aleksandër Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezartë Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Vjoleta Përndrecaj, Samed Bushati, Suada Kopshti, Marina Duhani, Anita Amuli, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Gusht 2025”.*
2. *Pr/Vendim: “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.*
3. *Projektvendim: “Për deklarin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshillitarit Bashkiak Z. Erkan Hoxha”.*
4. *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
5. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

**Z.Luli** fillon leximin e rendit të ditës dhe shprehet se janë paraqitur edhe dy pika shtesë për rendin e dites së sotme:

1. *Projektvendim: “ Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr.76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025-2027 të Bashkisë Shkodër” ( i ndryshuar).*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e ndryshimit të rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve kapitale tek shpenzimet korrente brenda të njëjtit program për vitin 2025”.*

Hidhet në votim rendi i ditës , ku rezultojnë **31** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

**Znj.Pode** merr fjalën dhe propozon që pika e parë, e tretë dhe pika e katërt e rendit të ditës nuk kanë nevojë për relativim.

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Gusht 2025”.*

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **31** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e rradhës: *Pr/Vendim: “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajtimit të njërive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.*

Relaton për këtë pikë **Znj.Leqejza**, drejtoreshë juridike, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Imeldi Sokoli**, i cili pyet se ku ndryshon kjo OJF me shoqatën për autonomi vendore, pjesë e së cilës jemi edhe ne dhe paguajmë nga buxheti jonë për sa i përket kësaj.

Përgjigjet **Znj.Leqejza** duke thënë se shoqata e bashkive ka një mision më të përgjithshëm dhe jo konkretisht në lidhje me këtë pikë që ne jemi duke shqyrtuar sot.Siç e referova unë më tej me vendimin e qeverisë është miratuar strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Pjesë e kësaj është dhe krijimi i kësaj akademie, që shkurtimisht quhet Talga.

**Z.Imeldi Sokoli** përsëri për replikë thotë se akademja në vetvete nuk nënkupton krijimin e një OJF-je. Akademia shumë mirë është një ndër propozimet kryesore të strategjisë në fjalë. Mund të jetë pjesë e një organi por nuk kemi nevojë që të kemi mbivendosje organesh. Siç është shoqata në këtë rast do të kemi edhe një akademi tjetër, që të jetë edhe OJF. Në këtë kuptim e shoh komplet të mbivendosur me gjënë. Shoqata e autonomisë vendore ka pasur raste që ka krijuar vetë trajnime për bashkitë dhe shumë mirë mund të funksionojnë kështu dhe më duket e tepërt që ne të kemi dhe një organ tjetër në këtë rast, që të bëjë po të njëjtën gjë që mund ta bëjë shumë mirë Shoqata e autonomisë vendore.

**Znj. Brikena Leqejza** përsërit se kjo iniciativë vjen si përgjigje ndaj sfidave të vazhdueshme të vetëqeverisë vendore dhe për ofrimin e shërbimit cilësor dhe për përgatitjen për procesin e integritetit në BE. Pra, kjo është një hap më përpara dhe misioni i saj është pak më i veçantë se ai i Shoqatës së Bashkive. Megjithatë, kjo është finalizuar me vendimin e qeverisë, ku ka autorizuar ministrinë

përgjegjëse për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**Z. Florian Bjanku** kërkon të dijë diçka më tepër për pjesën e kostos që do të ketë Bashkia në këtë rast, a ka ndonjë lloj planifikimi apo një lloj komunikimi, se sa do të shkojnë ose sa është vlera që do të na përfshijnë ne në këtë lloj projekti. Pra, që ta që ta sqarojmë pak, këto janë iniciativa faktikisht qeveritare për krijimin e këtyre personave juridikë. Ajo çfarë ka dëshmuar deri tash, pjesa e qeverisë qendrore, siç mund të na shohim është një reduktim i ndjeshëm i kompetencave të qeverisjes vendore në raport me qeverisjen qendrore. Pra, gjithnjë e më pak qeverisja vendore, ka kompetenca në raport me qeverinë, dhe kjo është tashmë edhe rasti i Shkodrës. Në Shkodër vazhdon zhvendosja e drejtorive, këtu kemi parasysh drejtorinë arsimore, kadastrën shtetërore dhe shumë institucione tjera që nuk kanë qenë institucione mirëfillti vendore, por periferike. Kemi parasysh faktin e fundit, që për Bashkitë edhe për procedurën e dhënies së lejeve vendoset nga institucioni qendror. Në një farë mënyre, po i merret fryma qeverisjes vendore. Na propozohet edhe krijimi i kësaj, sikur qeveria tashmë po na jep një lloj ndihmesë. Kur ndërkohë që shihet, që është krejt tjetër çasje. Dhe kjo është lehtësisht e dukshme dhe në këtë pikëpamje të dimë të paktën se sa do na kushtojë në buxhetin e Bashkisë, sepse ne kemi një buxhet i cili është i bazuar tek taksat dhe tarifat vendore.

**Znj. Brikena Leqeja:** Atëherë, me vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 76, dat 19.12.2024, ku është miratuar edhe buxheti i vitit 2025, është miratuar edhe kuota për krijimin e kësaj akademie. Kjo gjendet te programi A141, kuota Akademia e Pushtetit Vendor. Pra, është miratuar nga ana juaj. Vlera është 700 000 (shtatëqind mijë lekë).

**Z. Gëzim Galiqi,** shprehet se ky është proces i përpunuar, sepse edhe qeveria ka dhënë aprovimin, po edhe shoqata bashkive. Vërej që e ka dhënë aprovimin në vitin dy mijë e njëzet e katër dhe unë jam pak kompleks për mënyrën se si do të funksionojë një iniciativë e tillë. Është e qartë që iniciativa është për të rritur kapacitetet e njësive të qeverisjes lokale, po kush do të drejtojë këtë proces? Si do të përformojë një sistem i tillë? Kam një mori pikëpyetjesh, ndoshta ke ndonjë sqarim tjetër për këtë proces.

**Z. Luli** sqaron se kjo është subjekt i kompetenca të përbashkëta, zoti Galiqi, me qeverinë. Kështu që 50% e kuotave të qeverisë, pjesa tjetër është e bashkive.

**Znj. Brikena Leqeja:** përsërit se kjo akademi është krijuar për të qënë të përgatitur për hyrjen në BE, pra që të jemi sa më konkretë dhe sa më të përgatitur, për të bërë trajnime në lidhje me këto punonjës. Gjithashtu, kjo është edhe për ju, është edhe për të zgjedhurit. Nuk është vetëm për punonjësit, është edhe për të zgjedhurit.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e PS dhe PSD shprehen pro projektvendimit, ndërsa kryetari i BF shprehet se do të abstenojnë.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **24** vota Pro **1** Kundër **10** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në miratimin e Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 04.08.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

Hidhet në votim, Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** rsa Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën 3. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për deklarinimin e mbarimit para kohe të abstenojmandatit të Këshilltarit Bashkiak Z. Erkan Hoxha”.*

**Z.Luli** sqaron se Komisioni i Mandateve është mbledhur dhe Znj.Gjekaj në cilësinë e kryetarës së këtij komisioni vijon me leximin e relacionit të përgatitur.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër: *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*

Pyetje dhe diskutime për këtë pikë nuk ka.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë shtesë e rendit të ditës: *Projektvendim: “ Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr.76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025-2027 të Bashkisë Shkodër” ( i ndryshuar).*

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër shtesë: *Projektvendim: “Për miratimin e ndryshimit të rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve kapitale tek shpenzimet korrente brenda të njëjtit program për vitin 2025”.*

Relaton përsëri **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Znj. Valjeta Golemi** :Nga buxheti i vitit 2025, shohim që është i miratuar një fond prej 2.5 milionësh për uniformat e policëve të rinj. Po kështu, në 2026 dhe në 2027 është i planifikuar 2.5 milionë. Meqënëse është miratuar numri i punonjësve në fillim të vitit, pse është e nevojshme kjo shtesë fondi për uniformat e policisë?

**Z. Saimir Rustemi, drejtor i Policisë Bashkiake:** Kjo shtesë kërkohet për për shkak të ndryshimit të tregut, për shkak të konsumit të paparashikuar të uniformave të punonjësve aktual dhe për shkak të shtesës së punonjësve të rinj që kanë ardhur këtë muaj, është e domosdoshme për të arritur që t'i kompletojmë të gjithë punonjësit e policisë me të njëjtën standard uniformash.

**Znj. Valjeta Golemi:** Po për këtë është miratuar fondi në fillim...

Përgjigjet përsëri **Z. Rustemi** : Jo, nuk ka qenë i parashikuar për këtë çështje, për rinovim uniformash ekzistuese. Nuk ka qenë e parashikuar edhe shtesa e 11 punonjësve të rinj.

**Z. Gjergj Sokoli** :Së pari unë dëshiroj t'i falenderoj punonjësit e Policisë Bashkiake për punën e mirë që është bërë dhe vazhdon të bëhet me ardhjen e drejtuesit të ri. Por me keqardhje vërej që se paga e një inspektori të policisë bashkiake është e barabartë me dy mbledhjet tona. Pra, është përt të ardhur keq që me këtë pagë atyre I duhet të përballen ditë për ditë me qytetarë, me ata që njohin ligjin, por edhe me ata që nuk njohin ligjin. Përballja e tyre është me nxehtin e ftohtit, shpesh edhe deri në orën 12:00. Ne miratojmë në Këshill pagat e titullarit, miratojmë pagat e drejtuesve dhe punonjësve të bashkisë dhe nuk shohim pagat e inspektorëve të policisë bashkiake, pra do t'ju bëj thirrje që të mendohet për shtesa për pagat e tyre, të mendohet për shtesat e uniformave. Po përfitoj nga rasti që në projekt buxhetit e ri të përfshihet edhe rritja e pagës të inspektorëve të Policisë bashkiake.

**Znj. Jona Leqeja:** Shprehet se ka përshtypjen që një projekt vendim i tillë do ishte mundur të merrej edhe me vendimarrjen ekzekutive. Megjithatë doja të qartësohej që pjesa e uniformave në këtë rast, është pak specifike, sepse shumica e tyre vijnë të personalizuar, pra për punonjësin që i vesh dhe në momentin që mund të ketë edhe qarkullim të punonjësve, uniformat e mëpërparëshme bëhen të papërdorshme, pra lind nevoja që të rinovohet çdo vit . Dhe për këtë arsye unë e mbështes këtë shtesë fondi sepse bën sens dhe bie dakord edhe me parafolësin, me Z. Sokoli, që është e vërtetë që kjo është më shumë rëmdësi sepse ato janë imazhi i Bashkisë dhe i qytetit, prandaj duhen të kenë një pamje sa më dinjitoze.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës: *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Fjalën e merr **Znj.Gjekaj** dhe thotë se ajo ka dërguar edhe një e-mail, për dijeni edhe këshilltarëve. Ajo shton se si kryetare i Aleancës së Këshilltarëve Bashkiake Shkodër, ka depozituar një kërkesë drejtuar edhe Kryetarit të bashkisë referuar barometrit gjinor, i cili është plotësuar nga Bashkia Shkodër. Nga plotësimi i këtij barometri gjinor evidentohet që në Bashkinë tonë, asnjë grua nuk ushton detyrën e administratores së njësive administrative. Bazuar në këtë rezultat i jam drejtuar me një kërkesë Kryetarit të Bashkisë që në momentin e emërimeve të reja për administratore në njësitë administrative të merret parasysh emërimi i grave, duke iu referuar edhe ligjit për barazinë gjinore.

**Z.I. Sokoli**, në fakt, kam një koment dhe një pyetje. Po e filloj me komentin të parin dhe pyetjen të dytën. Shumë njerëz të qytetit tonë janë të shqetësuar për ndërtimin e kullës dhe fillimin e punimeve të ndërtimit të kullës. Ju në fakt, si administratë e qeverisjes vendore, keni një moment të artë për të vërtetuar që në ato karrige që jeni ulur, jeni ulur për të mirën e qytetit dhe jo për të mbajtur thjesht

një karrige. Dhe Shkodra do t'ia dinte shumë për nder në qoftë se ju do të bllokoni punimet e asaj kulle atje sepse ajo është cënim i gjithë interesit publik të qytetit të Shkodrës. Është cënim i planit të përgjithshëm vendor që ju vetë keni për detyrë ta zbatoni dhe ta implementoni. Raste të tilla që mund të refuzohet një leje e Këshillit Kombëtar të Territorit ka, dhe ne kemi precedentin e vitit 2015 në Bashkinë Shkodër. Ku është refuzuar një leje ndërtimi e Këshillit Kombëtar të Territorit nga Bashkia Shkodër. Edhe në këtë rast mua do më kishte ardhë shumë mirë si qytetar, si opozitar, që ju ta merrni parasysh këtë vendim dhe këtë zgjidhje, sepse shkodranët do t'ua dinin shumë për nder nëse se ju do të respektonit interesin publik të gjithë qytetit. Pika tjetër që është që kthehet në pyetje. Si ka mundësi që ju nuk e implementoni planin e përgjithshëm vendor me ato rregulla që ka sot plani? Ky vendim është komplet në kundërshtim me planin tuaj të përgjithshëm vendor që ju keni sot. Si ka mundësi që ju e lejoni një gjë të tillë? Normalisht që jeni të heshtur. Me këtë frymë politike që keni në udhë, nuk ka surpriza këtu. Juve ju vjen kryeministrit, iu shkarkon administratorët, dhe ju patjetër jeni okej.

Përgjigjet **Zv.Kryetari Z.Alban Preka** duke thënë se ka një leje të KKT-së, i cila i është dhënë një prone private për taatë. Dhe ajo leje që ju presupozoni që të mos jepet nga Bashkia Shkodër, nuk parashikon që ne t'i hyjmë vendimarrjes së KKT-së. Dhe ju e dini shumë mirë dhe mos e përdorni për të bërë propagandë. Ju siguroj që procedura është miratuar nga KKT-ja. Ka një leje për fillimin e punimeve, ashtu sikur e parashikon ligji, dhe nuk do të cënohet asnjë parametër ligjor për sa i përket kësaj.

**Z.I. Sokoli** replikon duke thënë se këtë ia kërkojnë qytetarët e Shkodrës. Ju e keni në dorë bllokimin e punimeve, ju që të merrni taksat që paguhet nga leja e ndërtimit, ndikimit në infrastrukturë . E bllokoni në qoftë se doni ta bllokoni sepse siç thashë kemi edhe një precedent. që është refuzuar leja e Këshillit Kombëtar të Territorit. Ju e keni shumë kollaj këtë punë, sepse fshiheni pas gishtit. Unë e di këtë punë, se ju thashë edhe një herë, që keni një kryeministër që ju dhunon sovranitetin tuaj. Ju keni në dorë dy rrugë, një rrugë ta zbatoni atë leje, apo t'i bini ndesh dhe të përfiton mirënjohjen e qytetit. Si doni, turpi juaj është gjithësesi.

**Znj. Shestani** shprehet se në adresën tonë elektronike ka ardhur një kërkesë prej përfaqësuesve të sh.a-së të Duhan-cigares, trashëgimtarëve të saj dhe kërkohet që të futet në rend të ditës kërkesa e tyre për të shfuqizuar vendimin e Këshillit Bashkiak nr.52 të 04.08.2025, miratuar nga ky Këshill, për transferimin e 89.65% të aksioneve të sh.a-së nga Ministria e Ekonomisë tek Bashkia Shkodër. Kërkesën e kanë bazuar në dokumentacionet përkatëse, ku citojnë se është nisur edhe me rrugë postare etj. Nuk është futur në rend të ditës tek kjo mbledhje dhe unë propozoj që mbledhjen e ardhshme të jetë në rend të ditës dhe të diskutojhet kjo kërkesë e këtyre trashëgimtarëve për këtë pronë.

**Z.Fatmir Vojvoda** kërkon të ketë informacion me shqetësimin e banorëve të Shosh-Shalë-Kir, në lidhje me bllokimin e rrugës. Ka më shumë se dy javë që janë të bllokuar dhe nuk shoh se është marrë asnjë masë për zhbllokimin e asaj rruge. Është një pengesë mjaft e madhe për banorët e asaj zonë. Ai shton se edhe situatë me qentë e rrugës përsëri është bërë shqetësuese. Po ashtu edhe personat që ecin në korsitë e bicikletave me patina, scooter dhe motora shpërndarës. Duhet mendohet për zgjidhje.

**Z.Preka** përgjigjet në lidhje me segmentin Shosh-Shalë-Kir, duke thënë se kemi filluar rihapjen e segmentit nga firma kontraktore. Nuk ka patur shkarje të tjera, ka filluar pastrimi e kontrolli patjetër në mënyrë që të verifikohet dëmi konkret dhe të shikohet mënyra e zgjidhjes definitive të aksit. Kam përshtypjen ndoshta deri ditën e nesërme do jetë pastruar pjesa e inertit që ka rënë në rrugë dhe do të shkojë një inxhinier për të konstatuar problemin kryesor që mund të jetë pjerrësia e rrugës, por

edhe nga verifikimet që janë bërë nuk ka dëmtim të trupit të rrugës, por për sigurinë e njerëzve që është parësore sepse terreni është i vështirë.

Në lidhje me situatën e qenve endacakë fjalën e merr **Z.Malaj**, drejtor i Bujqësisë , duke thënë se është e vërtetë situata që thotë këshilltari. Jemi para një problemi që na kanë sjellë shumë qen. Nuk e kemi të sigurt se prej nga, nga cilat rrethe apo cilat bashki të tjera. Është një situatë që na shqetëson. Jemi duke marrë me atë pjesë padiskutim. Për momentin jemi duke marrë me pjesën e qytetit të parën, sepse është më e rëndësishme dhe më shqetësuese, por do vijojmë gjithashtu edhe me fshatrat. Për momentin jemi të fokusuar tek Velipoja. Pastaj kemi Shirokën dhe do vazhdojmë me fshatra të tjera. Kemi pasur deri tani të dhëna për pjesën e Thethit dhe të Ndërlyses, kemi pasur edhe një denoncim, kemi shkuar atje e kemi parë situatën në terren.

**Z.Galiqi** merr fjalën dhe flet në lidhje me varrezat publike të qytetit, duke thënë se i pëlqen fakti që po punohen në varrezat publike dhe po shtrohen një pjesë rrugëve, që është fakt i mirëpritur për gjithë qytetarët, në shenjë respekti edhe për njërit e dashur që humbim. Duke pasur një eksperiencë edhe me varrezat publike përtej Shkodrës, mendoj që kemi varrezat publike më model në territorin e Shqipërisë, falë edhe faktit të qytetarisë që ka qyteti. Por ajo që më shqetëson, shton ai është që varrezat publike, si kudo, duhet të jenë një sistem i mbyllur. Në respekt të njerëzve që janë vendosur atje, kërkesa ime dhe një pyetje në kuadrin e këtij rristrukturimi të varrezave publike: A duhet të vijmë edhe ne te procesi i humbjes së atij tranzicionit që reflektojnë varrezat publike duke i mbyllur varrezat publike?

**Z.Altin Salihi** nga administrata shprehet se është drejt përfundimit një pjesë, një segment që është i hapur. Projekti po realizohet, nga rruga që asfaltohet do mbyllet edhe muri atje sepse është bërë rruga lidhëse. Krah u tjetër nuk do të jetë rrugë kalimi, pra do të jetë e kufizuar në çdo vend.

**Z. I Sokoli** përsëri thotë se për të vazhduar diskutimin që zonja Shestani ngriti. Dhe për t'i bërë një parantezë këtu, në mbledhjen paraardhëse u mor një vendim komplet i dyshimtë për sa i përket ndërmarrjes së Duhancigares. Dhe në fakt, atë ditë u ngritën hipoteza, sepse nuk kishte asnjë pasqyrë për gjendjen juridike apo për gjendjen financiare të Sh.a-së, apo gjendjen juridike të pronës që mbart në vetvete sh.a-ja dhe ne kemi një vendim të vitit 2022, që është hapur një proces gjyqësor për marrjen e pronës të kësaj sh.a-je. Dhe ne marrim një vendim komplet në hije, pa pasur asnjë lloj informacioni për gjendjen juridike të kësaj pronë. Pra, duam të marrim në kompetencën tonë një sh.a që ka një pronë që është në proces gjyqësor. Pra, duam ta marrim këtë sh.a me pajë me vete. Kur në fakt nuk i dimë aspak cilat janë qëllimet e Bashkisë për këtë kur mund të ketë prona të tjera që s'janë në proces gjyqësor. Pse duhet të hyjmë dhe të marrim një prone në proces gjyqësor, aq më tepër historiku na del që në fakt kjo sh.a është kërkuar nga vetë pronari i saj, që në këtë rast ishte Ministria. Cili është komenti juaj në këtë rast sepse ju po kërkonit të hyni me domosdoshmëri në një proces gjyqësor që s'kishte nevojë pse të hynit në një proces gjyqësor. Do të jeni palë tashmë e këtij procesi gjyqësor. Këtë gjë nuk e kuptoj pse ka ndodhur nga ana e Bashkisë dhe patjetër që kërkoj që në mbledhjen e ardhshme, pra ripërsëris kërkesën e zonjës Shestani, që të rishqyrtohet ky vendim këtu edhe një herë.

**Znj.Shala**, flet si banore e nr.3. Para pak kohëve, me pompozitet të madh u vunë semaforët. Sot po diskutojmë, për plan mobilitetit, etj. Unë shoh sot në krah të xhamisë tek rruga, që ai semafor është bërë pak qesharak. Rruga është mbyllur me beton. Ç'ishte ky investim i pa menduar mirë? Apo cila është arsyeja që është mbyllur ajo rrugë? Apo ishte thjeshtë reklam dhe para e hedhur kot? Do doja një shpjegim, cila është arsyeja që është bllokuar kjo rrugë?

**Z.Salihi** përsëri sqaron se kemi të bëjmë me bllokim sistemi sepse drejtorja e Qarkullimit Rrugor të Policisë së Shtetit ka kërkuar që rrugën mos ta bëjë me trafik ndarëse , në mënyrë që makinat të jenë

të detyruara të shkonë deri tek rotondoja, duke qenë se rruga tek dollari dhe rruga këtu dalin në të njëjtën rrugë për të marrë kthesën. Për këtë efekt është blloku sepse kjo është e hapur për të lejuar deri para pak kohësh, që të bëhet vizimi i ri, sinjalistika që të merret kthesa dhe të vazhdohet nga kryqëzimi i ish-Degës. Pra çdo gjë është bërë për të mos krijuar konfuzion trafiku në atë zonë, pasi të dyja rrugët që përmenda shkarkojnë në të njëjtin vend. Kjo ka qenë kërkesë nga Drejtoria e Qarkullimit Rrugor të Policisë së Shtetit.

**Përsëri Znj.Shestani**, pra domethënë ai investim paska qenë i pamenduar mirë.

**Z.Salihi** përsër shprehet se nuk është bërë asnjë lloj investimi sepse semaforët janë të dhuruar.

**Z.Bjanku** vijon në të njëjtën linjë të diskutimit që lidhet me pjesën e qarkullimit. Pjesa e pedonales së qytetit, pjesa e Gjuhadolit dhe pjesa e Piacës ka shumë problematika. Në fakt, është shtruar si diskutim disa herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për faktin se tashmë jemi në përfundim të sezonit turistik dhe ndoshta është mirë që disa investime ose disa organizime të fillojnë dhe të bëhen tani. Ka një lloj qetësie dhe ka një mundësi për të organizuar paksa më ndryshe një rrugë, e cila përcjell shumë shqetësime. Qoftë pjesës së turistëve, qoftë pjesës së kalimtarëve që hasin vështirësi. Mjetet e pronarëve të shtëpive aty kanë probleme shumë. Çasjen e tyre në aksesin e tyre në raport me shpijat, pra është një situatë e cila faktikisht, në qoftë se do të flasim për një vend normal, nuk mund të ndodhin, sepse askush nuk mund të çenojë aksesin në shtëpinë e tij. Pra ne kemi modelet e vendeve të tjera ku në zonat turistike me trafik të kufizuar, pjesa e rezidentëve kanë leje të veçanta dhe kanë mundësi për të aksesuar, plus që edhe nga pikëpamja e organizimit edhe të rrugëve, prej atyre konëve të cilat janë të lëvizsshme, detyrohet makina të kalojë në trotuar për të qarkulluar. Dhe kjo është një situatë e papranueshme në zemrën e qytetit, në zonën më të rëndësishme dhe me fluksin më të madh. Thjeshtë do të kërkoja të ishte në vëmendje, jo në kulmin e sezonit që ndoshta është i vështirë dhe e mirëkuptoj faktin që vështirë për të ndërhyrë në atë periudhë por duhet t'i paraprijmë sezonit të ardhshëm, duke marrë masa të kombinuara edhe me të drejtat e banorëve për akses në shtëpitë e tyre dhe të drejtat e kalimtarëve. Edhe për pjesën e infrastrukturës duhet të që investimet përsa i takon mirëmbajtjes, të bëhen në periudha më të qeta.

**Znj.Gjekaj** shprehet se duke përfituar nga rasti që është prezent drejtori i Policisë Bashkiake, kërkon vëmendje tek rruga At Shtjefën Gjeçovi dhe Palok Kurti dhe tek pjesa e një rrugicë tjetër që i ndërlidh bashkë këto dy rrugë sepse parkimi i makinave aty është bërë një problematikë shumë e madhe dhe po i zë frymën banorëve të zonës pasi nuk kemi ku të kalojmë dhe shpesh herë detyrohemi të ecim kundërvajtje për shkak të parkimeve.

**Z.Saimir Rustemi**, shprehet se duke filluar që nesër do merren masa urgjente për atë.

**Z. Pashuku**, shpreh ankesën e banorëve të zonës së Dajçit në lidhje me kanalin e parë vaditës Është i papastruar dhe duhet bërë një kërkesë Drejtorisë së Bordit të Kullimit Lezhë, që vitin e ardhshëm ta planifikojë impaktin në kufi me njësinë administrative me Bërdicën dhe të pasohet zona e kanalit të parë vaditës në territorin e Dajçit.

**Z.Salihi**, sqaron se vitin tjetër do të pastrohet sepse është në planin e vetë punës.

**Z.Shkjau** merr fjalën dhe falenderon Z.Rustemi për punën e bërë me ardhjen në krye të Policisë Bashkiake. Ai shton se ju të Bashkisë, duhet t'i zgjidhni sa më mire demokratët që janë zotë që të punojnë për qytetin dhe atë që nuk kanë llafe e flasin kot. Sepse unë shoh përkushtimin e madh këtyre djemve që të punojnë për qytetin dhe ju lumtë. Në administratën e qytetit janë shumë përsëmarit, prandaj bravo ju qoftë edhe ju që keni këtë tolerancë dhe mundohuni të zgjidhni ata që i punojnë.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 25.09.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban \_\_\_\_faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

***V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.***

**Sekretar**

**Sabina DANAJ**



**Zbardhi Pr/verbalin:**

**Irma Sulishti**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**

